



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Bulevardi "Zogu I", Godina 57/2, Nr.18 Tiranë

Tel/Fax 04 2226814; 2226814

Nr. 399 / Prot.  
5

Tiranë, më 24 .06.2016

V E N D I M

Nr. 73 , datë 24 .06.2016

**Mbi përfundimin e procedimit administrativ,  
filluar me urdhrin e verifikimit nr. 399/1 prot., datë 23.05.2016**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar; neneve 80-104 të ligjit nr. 8485 dt. 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", dispozita të cilat lejohen të veprojnë prej nenit 185 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me verifikimin e procedurës së konkurrimit për pozicionin "Drejtor i Drejtorisë së Gjeologjisë Detare" në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar,

**VËREJ SE:**

Në bazë të urdhrin nr. 399/1 prot., datë 23.05.2016 të Komisionerit, është kryer hetimi administrativ, për të verifikuar ligjshmërinë e zhvillimit të procedurës së konkurrimit, për ngritje në detyrë në kategorinë e mesme drejtuese, në pozicionin "Drejtor i Drejtorisë së Gjeologjisë Detare", në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar, ku ndërmjet të tjerëve ka konkurruar edhe nëpunësi \*\*\*\*\*.

Nga dokumentacioni i shqyrtuar ka rezultuar se, punonjësi \*\*\*\*\* , duke qenë nëpunës civil ekzistues, në pozicionin specialist në "Sektorin e Hartografimit pranë Drejtorisë së Gjeologjisë", në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar, ka aplikuar për konkurrimin e shpallur në faqen zyrtare të Departamentit të Administratës Publike, me nr. 782, për pozicionin "Drejtor i Drejtorisë së Gjeologjisë Detare", në datën 13.05.2015.

Si shkak për kryerjen e këtij hetimi administrativ, ka shërbyer pretendimi i ngritur nga nëpunësi i sipërpërmendur, se është skualifikuar pa të drejtë nga njësia paraseleksionuese e Departamentit të Administratës Publike, duke mos i dhënë mundësi të marrë pjesë në fazat e mëtejshme të konkurrimit.

Nga tërësia e dokumentacionit të administruar, rezulton se \*\*\*\*\* ka aplikuar për të marrë pjesë në procedurën e konkurrimit për ngritje në detyrë, për pozicionin “Drejtor i Drejtorisë së Gjeologjisë Detare”, i cili ishte shpallur rregullisht, me nr. 782, në faqen zyrtare të Departamentit të Administratës Publike.

Shkaku i skualifikimit në fazën e seleksionimit paraprak, lidhet me faktin se sipas njësisë kompetente të paraseleksionimit në DAP, konkurrenti në fjalë nuk përmbush kriterin e posaçëm të llojit të kualifikimit arsimor, siç parashikohet në përshkrimin e punës dhe që është bërë publike në shpalljen e pozicionit që do të plotësohet nëpërmjet konkurrimit.

Konkretisht, kjo njësi ka arritur në përfundimin se konkurrenti \*\*\*\*\* nuk ka kualifikimin “Master Shkencor për Gjeologji Naftë”, siç kërkohet për të drejtuar Drejtorinë e Gjeologjisë Detare e për këtë arsye nuk mund të vazhdojë më tej konkurrimin. Në të njëjtën kohë kjo njësi ka konstatuar se kandidati në fjalë nuk ka bërë njehsimin e diplomës “D’etudes Approfondies” në Shkenca Gjeologjike marrë në Universitetin Orleans, në Francë, parregullsi kjo që e penalizon atë.

Ndaj vendimit të skualifikimit, konkurrenti \*\*\*\*\* , ngre pretendimin se ai ka kualifikim arsimor të barasvlefshëm me atë që kërkon pozicioni i punës “Drejtor i Drejtorisë së Gjeologjisë Detare”, pasi ka një eksperiencë të gjatë në punët gjeologjike dhe për më tepër është diplomuar në Universitetin e Orleansit me diplomën “D’etudes Approfondies” në Shkenca Gjeologjike, e cila ka shërbyer si bazë për të marrë gradën shkencore “Doktor i Shkencave”.

Për verifikimin dhe vlerësimin e këtij pretendimi u mblodh dokumentacioni i nevojshëm nga analiza e të cilit, arrihet në përfundimin se vendimi i njësisë paraseleksionuese të DAP, për skualifikimin e konkurrentit në fjalë është i drejtë.

Në shpalljen e konkurrimit, në pikën 2.1 “Kushtet që duhet të plotësojë kandidati për procedurën ngritje në detyrë dhe kriteret e veçanta”, është parashikuar shprehimisht që nëpunësit të cilët do të merrnin pjesë në këtë procedurë për ngritje në detyrë, duhet të jenë të pajisur me diplomë të nivelit “Master shkencor”, në Gjeologji Miniera, dega Inxhinieri Gjeologji Naftë, si dhe të zotërojnë minimalisht gradën shkencore “Doktor i Shkencave”, në fushën e Gjeoshkencave.

Njësia paraseleksionuese e DAP, pasi ka bërë verifikimin e dokumentacionit të paraqitur nga kandidati \*\*\*\*\* , në lidhje me përmbushjen e kërkesave të përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara në shpalljen për këtë pozicion pune, ka arritur në përfundimin se ai nuk përmbushte kriterin e llojit të kualifikimit arsimor, pasi nuk zotëronte diplomë të nivelit “Master Shkencor” në degën Inxhinieri Gjeologji Naftë, e për më tepër, nuk kishte bërë njehsimin në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, të gradës shkencore “Doktor i Shkencave”, në fushën e Gjeoshkencave që ai kishte fituar pas marrjes së diplomës “D’etudes Approfondies” në Shkenca Gjeologjike, nga Universiteti Orleans, në Francë.

Ky konkluzion i njësisë paraseleksionuese vlerësohet i drejtë, sepse pozicioni i punës “Drejtor i Drejtorisë së Gjeologjisë Detare”, në bazë të pikës 8/b, të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, përfshihet në kategorinë e administrimit të posaçëm, dhe ka të bëjë

me ushtrimin e përgjegjësive specifike në një linjë të caktuar shkencore dhe ushtrimi i tyre kërkon njohuri të posaçme, dhe një kualifikim të caktuar.

Në këtë kuadër edhe në Vendimin nr. 142, dt. 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, në Lidhjen nr. 2, Klasa III/1, Klasa III/2 dhe Klasa IV/1, është përcaktuar se kualifikimi arsimor për pozicionet e punës të administrimit të posaçëm, duhet të jetë në nivelin “Master Shkencor”, duke kërkuar që kandidati në mënyrë të veçantë, të ketë njohuri të gjëra dhe shumë të mira të specialiteteve brenda një fushe të caktuar shkencore e profesionale dhe të politikave e programeve lidhur me fushën e specialitetit, gjë e cila prezumon kualifikimin e thellë në atë linjë shkencore.

Ky është shkak, që njësia përgjegjëse, në bashkëpunim me institucionin përkatës, kur ka bërë analizën e karakteristikave të pozicionit “Drejtor i Drejtorisë së Gjeologjisë Detare”, ka përcaktuar që kandidatët të cilët do të marrin pjesë në konkurrim për këtë pozicion të plotësojnë kushtin e një kualifikimi të caktuar arsimor dhe shkencor, në degën e Gjeologjisë së Naftës.

Në rastin konkret, megjithëse konstatohet që konkurrenti \*\*\*\*\* në përgjithësi paraqitet me një nivel të mirë formimi intelektual dhe ka disa kualifikime universitare e pasuniversitare, si në universitete të vendit ashtu dhe në universitete të huaja, për pozicionin “Drejtor i Drejtorisë së Gjeologjisë Detare”, ku ai ka aplikuar për konkurrim, nuk plotëson kushtin e arsimit specifik që kërkohet për atë vend pune.

Pretendimi se kualifikimi i tij është i ngjashëm me degën që kërkohet për atë pozicion pune, nuk mund të merret parasysh, pasi ato figurojnë si degë studimi të veçanta në Fakultetin Gjeologji Miniera dhe përfaqësojnë dije të fushave të ndryshme.

Nisur nga arsyetimi i mësipërm, arrihet në përfundimin se njësia përgjegjëse, në rastin e skualifikimit të konkurrentit \*\*\*\*\* , ka vepruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” dhe Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”.

#### **Për këto arsye:**

Bazuar në nenet 14 e 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; nenet 16, pika 6 dhe 34 pika 1, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

#### **VENDOSA:**

1. Përfundimin e procesit të verifikimit, të nisur me Urdhrin nr. 399/1 prot., datë 23.05.2016, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil “Për verifikimin e informacionit të ardhur nga një nëpunës i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, në lidhje me parregullsi të pretenduara gjatë kryerjes së procedurës për ngritje në detyrë, në kategorinë e mesme

*drejtuese, për pozicionin “Drejtor i Drejtorisë së Gjeologjisë Detare”, në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar”, pasi nuk konstatohen shkelje të ligjshmërisë nga ana e njësisë përgjegjëse (DAP), gjatë kryerjes së procedurës së konkurrimit për ngritje në detyrë.*

2. Të njoftohet për këtë vendim, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Departamenti i Administratës Publike dhe ankuesi \*\*\*\*\* .

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**